

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), për realizimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2026 në Shqipëri, INSTAT shpall thirrje për aplikim (kontrate te perkohshme) nga kandidatet femra të interesuara për angazhim në punë në terren, për pozicionin dhe detyrat e përshkruara më poshtë:

ANKETUES TERRENI

Shpërndarja e pozicioneve sipas bashkive (link):

https://www.instat.gov.al/media/weheookf/copy-of-shperndarja-e-punonjesve-sipas-garqeve_mics-2026.pdf

- Afati aplikimit: 16.12.2025
- Periudha e trajnimit: 07.01.2026 – 23.01.2026
- Periudha e terrenit: 26.01.2026 – 26.03.2026

Trajnimi është i detyrueshëm cdo ditë. Gjatë këtij trajnimi do të realizohet një proces i vazhdueshëm vlerësimi, dhe në përfundim, vetëm kandidatët e suksesshëm do të përzgjidhen për fazën e punës në terren. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetaret (femra) e Shqipërisë, që janë mbi moshën 18 vjeç, që kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave përkatëse.

Afati për shprehjen e interesit: deri më 16.12.2026.

Mënyra e shprehjes së interesit: pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Instituti i Statistikave, ose me email në adresën: ahoxholli@instat.gov.al.

Detyrat kryesore të Anketueses:

- Pjesëmarrje në trajnim dhe njohje e plotë me udhëzimet për intervistuesit të anketës, përfshirë: pyetësin e njësisë ekonomike familjare; pyetësin individual për gratë; pyetësit për fëmijët nën moshën pesë vjeçare; pyetësit për fëmijët e moshës 5-17 vjeçare;
- Me ndihmën e Kontrolluesit të terrenit, të identifikojnë njësitë ekonomike familjare të përzgjedhura që u janë caktuar dhe të zhvillojnë pyetësit;
- Zbatimin e saktë të udhëzimeve dhe procedurave të pyetësorëve dhe manualeve përkatëse;
- Bashkëpunim me ekipin dhe ndjekje e udhëzimeve të kontrolluesit;
- Të intervistojnë të gjithë personat e përshtatshëm për t'u anketuar në njësitë ekonomike familjare që u janë caktuar;
- Të kontrollojnë intervistat e përfunduara për t'u siguruar se janë bërë të gjitha pyetjet;

- Të kryejnë ri-vizita për të intervistuar personat që nuk mundën të intervistohen gjatë vizitës së parë apo të dytë, për arsye të ndryshme;
- Të sigurohen që informacioni i dhënë është i saktë duke e mbajtur të anketuarin të përqendruar te pyetjet;
- Të regjistrojnë vëzhgimet e tyre specifike mbi çështjet e hasura në njësitë familjare, në bllokun e shënimeve të vënë në dispozicion;
- Të përgatisin shënime shtesë për ti ndarë me Kontrolluesin e terrenit mbi probleme ose vëzhgime të tjera;
- Transmetimi i te dhënave çdo ditë tek kontrolluesi.

Aftësi të kërkuara:

- Komunikim dhe bashkëpunim efektiv në grup;
- Gatishmëri për të punuar në grup dhe për të ndjekur udhëzimet e mbikëqyrësit;
- Preferohet të kenë aftësi për orientim në terren dhe përdorim të hartave për identifikimin e vendbanimeve;
- Të jenë të gatshëm për të përballuar kushtet atmosferike duke pasur parasysh që puna kryhet në terren dhe mund të kërkojë ecje të gjata.

Kualifikimet:

- Preferohet të jenë studentë në nivelin bachelor ose të kenë përfunduar së paku ciklin e parë të studimeve universitare;
- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative, në veçanti përdorimin e pajisjeve si laptopë dhe/ose tabletë;
- E preferueshme të kenë përvojë të mëparshme në realizimin e anketave dhe intervistimeve të ngjashme në terren.